



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

EKSTRAKT

Nga procesverbali i mbledhjes së 22-të të Komitetit për Komunitete të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 28. 02. 2020, në sallën për mbledhje me fillim në ora 14,⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Skender Bikliqi, Kryesues i Komitetit për Komunitete
2. Naim Jahiri
3. Lulzim Rustemi
4. Egzona Fazlija
5. Arben Salihu
6. Ferat Gashi
7. Slavisa Trajkovic
8. Zoran Çirković

Të tjerë prezent

1. Lulzim Qerimi, nënkryetar i komunës për komunitete
2. Arben Koshi, OSBE
3. Luaras Oseku, OSBE
4. Naser Bytyqi, përkthyes shqip-serbisht

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**,

Kryesuesi i Komitetit për Komunitete, Skender Bikliqi, përshëndeti të pranishmit. Në vazhdim tha se rendin e ditës e keni marrë dhe pyeti a ka dikush vërejtje apo plotësime?

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë askush nuk u lajmërua për fjalë, kryesuesi vuri në votim rendin e ditës së propozuar dhe pas votimit konstatoi se Komiteti për punën e kësaj mbledhje unanimisht aprovoi këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 21-të e Komitetit për Komunitete.
2. Informatë nga Drejtorati për Bujqësi rreth subvencioneve për ekonomi familjare dhe fermer
3. Raporti i punës së ZLK-së, për vitin 2019
4. Të ndryshme

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 21-të të Komitetit për Komunitete

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Skender Bikliqi, pyeti anëtarët e Komitetit, se a ka dikush vërejtje, apo plotësime, në ekstraktin nga mbledhja e 21-të?

Megjë vërejtje nuk pati, Kryesuesi të njëjtin e vuri në votim dhe pas votimit, konstatoi se Komiteti unanimisht.

Aprovoi

Ekstraktin nga mbledhja e 21-të të Komitetit për Komunitete

Shtesë: Ekstrakti.

Pastaj u kalua në pikën e dytë të rendit të ditës.

II

Informatë nga Drejtorati për Bujqësi rreth subvencioneve për ekonomi familjare dhe fermer

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Skender Bikliqi, i dha fjalën Shefqet Amerllahut, drejtor i DBPZHR, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Informata.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Slavisa Trajković, qfarë kritere duhet të plotësohen për të aplikuar për subvencione dhe ku mund të merret aplikacioni?

Shefqet Amerllahu, kriteret janë në bazë të Rregullores të cilën e ka nxjerr Kuvendi, ndërsa aplikacionet mund t'i marrin në sportel nr. 1.

Zoran Çirković, e falënderoj drejtorin për informatën nga komuniteti në vitin e kaluar kanë përfituar tre persona por nuk kemi marrë informata sakt se kush janë ata persona të cilët kanë përfituar po ashtu gjatë vizitës në teren njëri prej aplikuesve është refuzuar edhe pse ka përfituar para 5 viteve. Sa i përket motokultivatorëve nuk është asnjë përfitues nga komuniteti serb.

Shefqet Amerllahu, lista e përfituesve ka qenë publike dhe ata që kanë përfituar kanë mund që ta shohin emërin në listën të cilën e ka përzgjedhë një komision i cili ka qenë në teren, ndërsa ata të cilët nuk kanë përfituar kanë pas të drejtë ankese.

Slavisa Trajković, unë kisha shprehur dëshirë që t'i marrë njoftimet dhe aplikacionet me veti dhe t'ua shpërndajë komunitetit ose t'i vendosi njoftimet në shtyllat elektrike që sa më shumë komuniteti të jenë të njoftuar.

Zoran Çirković, është mirë që të ketë një tabelë të shpalljes në fshatin Grackë ku aty do të vendoseshin njoftimet rreth komunitetit.

Shefqet Amerllahu, ne nuk kemi buxhet për një gjë të tillë si drejtorat por është mire që t'i drejtoheni zyrës së Kryetarit.

Arben Salihu, e falënderoj drejtorin për informatën e dhënë sa i përket shpërndarjes së njoftimit nga ana e Sllavishës në Komunitet ai njoftim është i publikuar në web faqe dhe nuk ka asgjë të keqe. Kërkesa ka të shumta për subvencione po shpresojmë që të rritet numri i buxhetit dhe të ketë sa më shumë përfitues.

Lulzim Rrustemi, e falënderoj drejtorin për informatën me sa po shihet te komuniteti 50% të cilët kanë aplikuar edhe kanë përfituar.

Nga komisioni i ankesave kemi informatë se nga komuniteti nuk ka pasur asnjë ankesë. Ndërsa sa i përket njoftimit shërbimi i Kuvendit po shpreh gatishmëri që të ju sjellë materialet.

Naim Jahiri, e falenderoj drejtorin për informatën dhe punën .

Sa i përket subvencioneve e dijmë që ka kërkesa të mëdha por shpresojmë që të ketë rritje të buxhetit dhe të ketë sa më shumë përfitues.

Lulzim Qerimi, nënkryetar i Komunës për komunitete, e falenderoj drejtorin për punën që po e bënë me sa shihet kemi 270 përfitues, ndërsa sa i përket komunitetit tone është fitues vetëm një por kjo është çështje e komisionit dhe komisioni e ka kryer punën në mënyrën më të mirë të mundur.

Skender Bikliqi, edhe unë falenderoj drejtorin për informatën dhe punën që po e bënë shpresojmë që edhe drejtorët tjerë të jenë prezent kur të ftohen.

Meqë diskutime të tjera nuk pati rreth kësaj pike, u kalua në pikën e radhës.

III

Raporti i punës së ZLK-së, për vitin 2019

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Skender Bikliqi, i dha fjalën Radmilla Simionoviq, e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Zoran Çirkovic, kam pyetje për një familje të komuniteti ashkali në Grackë ZLK-ja a ka qenë në teren për ta vizituar.

Naim Jahiri, e falenderoj Radmillën për punën që po e bënë kam një pyetje për familjen e Elmi Berishes në Sllovi, ka një kërkesë për renovimin e ujit në banjo pasi që po ka problem.

Radmilla Simionoviq, sa i përket familjes në Grackë me këtë do të merret KARITAS, ndërsa për familjen në Sllovi do të shohim çka mund të bëjmë.

Meqë diskutime të tjera nuk pati rreth kësaj pike u kalua në pikën të ndryshme

IV

Të ndryshme

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Komitetit për Komunitete, Skender Bikliqi, tha se a ka dikush të diskutoj rreth kësaj pike.

Lulzim Qerimi, ne komuniteti ashkali me 15 Shkurt e kemi pasur ditën e flamurit ashkalinjëve ku jemi mbështetë nga Kryetari me 500€ dhe në këtë takim kemi pas përfaqësues të komuniteteve dhe Kryetari Komunës.

Po ashtu kemi nënshkruar një marrëveshje me organizatën VoIC RAE për qendrat e mësimi shtesë ku përfshihen Lipjani, Magura, Janjeva dhe Medveci.

Unë i kam vizituar të gjitha shkollat ku mësojnë komuniteti jonë dhe jam ndarë shumë i kënaqur me punën që po e bëjnë drejtorët e shkollave së bashku me stafin e tyre.

Meqë çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 15⁵⁰.

Ekstraktin e hartoi
Behar Aliu

Kryesuesi i Komitetit
Skender Bikliqi